



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 20.05.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:09 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Medi Bici.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Marjana Papa, OSCE.*
- 7. Krisi Kllapi, Qendra Evropiane.*
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Alketa Vushaj, KSHH.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Charles Ericksen, USAID.*
- 13. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 14. Olta Lolo, USAID.*
- 15. Erjon Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Po fillojmë mbledhjen e datës 20.05.2019.

Janë të pranishëm që të gjithë anëtarët, përveç zotit Medi, i cili ka njoftuar për mos prezencën e tij për shkak të angazhimit në Shkollën e Magjistraturës. Siç ju kam vënë në dijeni, sot në rendin e ditës janë 4 çështje për t’u diskutuar.

Çështja e parë për t'u diskutuar është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Çështja e dytë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, i përgatitur edhe ky nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Çështja e tretë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Dhe çështja e katërt është: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” dhe ky i përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës.

Atëherë, kalojmë me çështjen e parë të rendit të ditës.

Siç jeni vënë në dijeni, një nga detyrimet që kishte Këshilli i Lartë Gjyqësor ishte që brenda 4 muajve duhet të merrte masa për ngritjen e Këshillave Gjyqësorë nëpër gjykata. Jam shumë e lumtur që në këtë mbledhje ne do prezantojmë këtë projekt-akt i cili finalizon edhe procesin e ngritjes së këshillave nëpër gjykata, duke miratuar në këtë lloj mënyre edhe rregullat e funksionimit të këtyre këshillave. Projekt-akti i propozuar nga Komisioni është një projekt-akt i cili i është nënshtruar një konsultimi si të brendshëm dhe të jashtëm. Kur flas për të brendshëm, jo vetëm ndërmjet anëtarëve të këtij Këshilli, por edhe me të gjithë gjykatat, dhe kur flasim për të jashtëm, kam përshtypjen që është bërë me asistencën e të dy projekteve që asistojnë Këshillin në veprimtarinë e tij, përfshirë “Justice for all” (“Drejtësi për të gjithë”) dhe EURALIUS-i.

Për më shumë detaje, fjalën ia kaloj kryetares së Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatimin e projekt-aktit, zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Ashtu sikundër edhe ju relatuat, detyrimi për hartimin e këtij projekt-akti buron nga dispozitat e ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, konkretisht neni 28 i ligjit, i

cili ngarkon Këshillin e Lartë Gjyqësor që të miratojë rregulla të detajuara për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit. Nga kjo dispozitë rezulton që të gjitha rregullat që ne duhet të miratojmë për mënyrën e funksionimit të mbledhjes kanë kryesisht një natyrë procedurale, për shkak se lënda që përbën objekt shqyrtimi për Këshillin është e parashikuar në një dispozitë të veçantë e ligjit, konkretisht në nenin 38 të tij, ku parashikohen të gjitha kompetencat që ka Këshilli i Gjykatës.

Rregullorja ka kaluar në disa hapa procedurale për të arritur deri në draftin përfundimtar. Ashtu sikundër edhe ju relatuat, çdo draft i përgatitur iu është dërguar për mendim dy misioneve; iu është dërguar në rrugë elektronike kryetarëve të gjykatave për ta diskutuar me gjykatat e tyre. Në dijeninë time, është bërë edhe pjesë e diskutimit të mbledhjes së kryetarëve dhe përfundimisht, jo të gjitha gjykatat, por disa nga kryetarët e gjykatave na kanë dërguar edhe mendimet e tyre lidhur me këtë projekt-akt, të cilat janë pjesë e dokumentacionit që kanë edhe anëtarët përpara, sepse është përgatitur një relacion i hollësishëm mbi të gjitha komentet dhe mendimet e kryetarëve të gjykatave.

Ne si Komision, pasi kemi marrë komentet e mësipërme, pasi kemi marrë gjithashtu edhe komentet e vazhdueshme me korrespondencën që kemi patur me dy misionet, kemi arritur në draftin përfundimtar që ju keni sot përpara sysh.

Në hartimin e këtij projekt-akti, janë mbajtur parasysh parimet e rëndësishme të mënyrës së administrimit të gjykatave. Tashmë kemi një koncept të ri të administrimit të gjykatave, ku kompetencat janë të ndara ndërmjet Këshillit të Gjykatës, kryetarit të gjykatës dhe kancelarit të gjykatës. Për të ruajtur pavarësinë në mënyrën e administrimit të gjykatave, ne si Komision kemi marrë parasysh edhe përbërjen e Këshillit të Gjykatës në varësi të rasteve kur do të mungonte ndonjë anëtar. Pra përbërja e zakonshme normale e Këshillit të Gjykatës është kryetari, zëvendëskryetari dhe kancelari. Mund të ndodhë që në një situatë për shkak të problemeve, për arsye objektive, një nga anëtarët gjyqtar të mungojë, nisur kjo edhe nga situata aktuale ku shumica e gjykatave sot drejtohet nga zëvendëskryetarët, prandaj ka lindur si domosdoshmëri që kjo rregullore të rregullojë edhe mënyrën e kompozimit të Këshillit të Gjykatave, në raste të tilla. Si anëtar zëvendësues është vendosur gjyqtari që ka dalë i dyti në listën e gjyqtarëve të zgjedhur

për zëvendëskryetar ose në mungesë të tij, gjyqtari me përvojën më të gjatë profesionale. Ky është një rregullim i ri që gjen pasqyrim në rregullore. Nuk është i pasqyruar në ligj.

Thashë edhe një herë, nevoja për të parashikuar përbërjen e Këshillit të Gjykatës në rastet normale të veprimtarisë së tij, e kërkon si domosdoshmëri parashikimin e anëtarëve zëvendësues në një situatë normale kur do të funksiononte Këshilli i Gjykatës. Për të zbatuar parimin e vetë administrimit, kemi menduar që si anëtar zëvendësues, gjithmonë në rastin kur do të mungonte kryetari ose zëvendëskryetari, të ishte gjithmonë një nga anëtarët gjyqtarë të të njëjtës gjykatë. Sipas rregullit, gjyqtari që ka dalë i dyti në listën për zëvendëskryetar dhe më tej nëse nuk do të ketë të tillë, gjyqtari me përvojën më të gjatë profesionale.

Kjo është situata normale kur do funksionojë Këshilli.

Për shkak të lëndës, vetë ligji ka parashikuar dy mënyra të ndryshme të kompozimit të Këshillit të Gjykatës, kur bëhet fjalë për çështje që kanë lidhje me kancelarin, përveç procedimit disiplinor, i cili bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe për çështje që kanë të bëjnë me nëpunësit civilë, ku ka parashikuar një përbërje të ndryshme të tij.

Në rastin e kancelarit, Këshilli i Gjykatës përbëhet nga 3 gjyqtarë. Është kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtari që ka dalë i dyti në listën e zgjedhjes për zëvendëskryetarë. Edhe në këtë rast, në rregullore janë parashikuar mënyra e zëvendësimit të secilit nga anëtarët, nëse ai nuk do të ketë mundësi të jetë i pranishëm, por është vendosur si periudhë që kjo mungesë duhet të jetë mbi 1 muaj ose më gjatë. Është vendosur parimi 1 muaj duke patur parasysh që duke ruajtur një vijueshmëri të zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit të Gjykatës, kemi parashikuar në rregullore që Këshilli i Gjykatës duhet të mbledhet si rregull, një herë në muaj, në bazë të një kalendari që e miraton vetë ai në fillim të çdo viti. Kjo edhe për të ruajtur jo vetëm një rregullshmëri por për të krijuar edhe një formalizim të veprimtarisë në mënyrë të njëjtë për të gjitha gjykatat, pastaj datën e zhvillimit të mbledhjes e vendos secili kryetar, i cili është edhe kryetari i Këshillit të Gjykatës, në varësi të çështjeve që ai ka për diskutim dhe që shfaqen dhe që kanë rëndësi për natyrën e përditshme të administrimit të gjykatës.

Një çështje që kemi marrë shumë në shqyrtim dhe që është diskutuar edhe me misionet, ka qenë problemi i mënyrës se si do të zëvendësohet kancelari i gjykatës në rastin kur ai mungon në detyrë për më shumë se 1 muaj ose edhe më gjatë. Funksionet e kancelarit janë të parashikuara në një dispozitë të veçantë të ligjit dhe i vetmi parashikim ligjor është që kancelari mund të zëvendësohet vetëm kur Këshilli i Gjykatës merr në shqyrtim çështjet që kanë të bëjnë me nëpunësit civilë. Ligji nuk parashikonte se çfarë do të ndodhte kur në një situatë normale, kancelari i gjykatës nuk do të ishte në punë. Sot për shembull, aktualisht kemi disa gjykata ku nuk ka kancelarë dhe funksionet e kancelarit ushtrohen nga nëpunës të tjerë gjyqësor. Kemi patur para dy alternativa. Duke ndjekur parimin që ligji parashikonte që në rastet kur mungonte kancelari, gjithmonë për lëndën që ka patur në shqyrtim, ai zëvendësohet nga një nëpunës civil i lartë i caktuar nga KLGJ, kemi parashikuar që edhe në një situatë normale kjo mund të ndodhë. Pra, në qoftë se Këshilli ka për të diskutuar një çështje veç asaj të parashikuar nga pika 4 e dispozitës që ka të bëjë për shembull me caktimin e seksioneve, trupave gjykues, apo informacionet e ndryshme që duhet të japë, dhe kancelari nuk ndodhet në detyrë, zëvendësimi i tij do të bëhet gjithmonë nga një nëpunës i lartë i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kemi arritur në këtë përfundim, për arsye sepse kompetencat e kancelarit, të parashikuara në ligj, janë shumë të rëndësishme, të tilla që kancelari normalisht çdo ditë duhet të jetë në gjykatë, por jo çdo kompetencë e kancelarit në vlerësimin tonë, mund t'i delegohet një nëpunësi gjyqësor civil për ta ushtruar.

Kryesisht, sot nëpër gjykata, në këto gjykata ku mungojnë kancelarët, nëpunësit gjyqësorë civilë ushtrojnë jo të gjitha kompetencat e kancelarit por disa funksione të administrimit të përditshëm, siç mund të ketë rregullat e mirëfunksionimit të shortit, etj. Prandaj, kemi vlerësuar që për kompetencat që janë thelbësore të lidhura me figurën e kancelarit, siç është anëtarësia e tij me të drejtë vote në Këshill, ai nuk mund të zëvendësohet dot nga nëpunësi gjyqësor që mund të ushtrojë funksionet e kancelarit në momentin që ai për arsye objektive nuk paraqitet në detyrë, megjithatë ky ka qenë mendimi dhe ajo çka Komisioni ynë ka vlerësuar.

Për diskutim ndoshta edhe mund të shtrohet në mbledhje nëse ka ndonjë vlerësim të ndryshëm nëse nëpunësi gjyqësor civil që ushtron funksionet e tij, njëkohësisht të

marrë pjesë edhe në Këshill, sepse kjo për shembull do të ndihmonte në zhvillimin e mbledhjeve më efektive se sa të pritët të caktohet nëpunësi i lartë i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nga ana tjetër do të ruante edhe atë pavarësinë në administrim, ku gjykata duhet të administrohet nga vetë punonjësit e saj. Varianti që u relatua më lartë është ai që kancelari në të gjitha rastet, qoftë për shkak të lëndës, qoftë në një situatë normaliteti, në rastet se mungon më shumë se 1 muaj, duhet të zëvendësohet nga një nëpunës i lartë civil, i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Më pas janë parashikuar mënyra se si thirret mbledhja e gjykatës, rendi i ditës.

Një risi që përbën për këtë rregullore është rasti kur anëtari mund të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit edhe në rastet kur ai nuk është fizikisht, por mundet që pjesëmarrja e tij të regjistrohet, të regjistrohet diskutimi nëpërmjet mjeteve të tjera të teknologjisë, gjithashtu edhe vota e tij. Është parashikuar mënyra e votimit. Nuk lejohet abstenimi. Janë ndjekur disa parime të mënyrës së funksionimit edhe të mbledhjes plenare të adoptuara për Këshillin e Gjykatës. Është parashikuar gjithashtu që në kuadër të funksioneve që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, Këshilli i Gjykatës, një herë në tre muaj, mund të raportojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për të gjithë veprimtarinë që ai ka zhvilluar lidhur me kompetencat e parashikuara nga ligji.

Këto ishin shkurtimisht pikat kryesore në të cilat bazohet hartimi i rregullores. Për të diskutuar thashë është pjesa... Ne kemi lënë akoma... Komisioni ka edhe propozimin që zëvendësimi i kancelarit duhet të bëhet nga një nëpunës i lartë civil i caktuar në KLGJ. Në qoftë se mendoni që mund ta zëvendësojë kancelarin edhe nëpunësi i gjykatës që ushtron funksionet e tij gjatë kohës që ai mungon në gjykatë, mund të ketë diskutime.

Ideja është që, -tani po flas edhe në vlerësimin tim – jo të gjitha kompetencat e kancelarit mund t'i delegohen një nëpunësi tjetër gjyqësor në gjykatë. Edhe pse ligji në fakt nuk e parashikon, kryetari është detyruar që të sigurojë mbarëvajtjen e mënyrës se si administrohet gjykata dhe sigurisht që në rast të mungesës së kancelarit, kompetencat e tij mundet që t'ia delegojë një sekretari gjyqësor, -po e marrë për shembull. Por këto kompetenca kanë të bëjnë thjesht me administrimin se si ndodh në gjykata, se si kryhet veprimtaria e përditshme e gjykatës. Nuk mundet dhe nuk e ka kompetencë ligjore

kryetari sepse vetëm në këtë mënyrë mund të zëvendësohet kancelari me anë të një nëpunësi tjetër gjyqësor të gjykatës, që t'i delegojë këtij nëpunësi kompetencat thelbësore që lidhen me kancelarin. Kjo ka qenë e gjithë arsyeja që gjithmonë është ndjekur parimi që kancelari duhet të zëvendësohet nga një nëpunës civil më i lartë dhe më i larti është konkretisht nëpunësi civil më i lartë dhe më i larti konkretisht është nëpunësi civil që mund të caktojë KLGJ-ja. Kjo është pikë që mbetet për diskutim.

Kush ka mendime?

Po, Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nëpunësit tanë, nga këtu.

Është ndjekur i njëjti parim si në rastin e nenit 27, pika 5.

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim lidhur me projekt-katin e propozuar nga Komisioni përkatës?

Maksim Qoku: Vetëm një pyetje, për sqarim.

A mundet që ne këtë nëse e bëjmë me kancelarin e Gjykatës së Apelit, në juridiksion që ka atë gjykatë?

Brikena Ukperaj: Atëherë, që të inkorporojmë ose të përfshijmë një rregullim, këtë që thatë ju, duhet të kemi një mbështetje ligjore për ta përfshirë këtë rregullim. Kancelari i Gjykatës së Apelit nuk është nëpunës gjyqësor më i lartë i kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë, e para. Duhet të ruajmë mënyrën e administrimit nga vetë gjykatat dhe logjikën që ndjek ligji në parimin e zëvendësimit të kancelarit.

Sigurisht që duhet të sigurojmë efektivitetin e zhvillimit të mbledhjes dhe efektiviteti i zhvillimit të mbledhjes sigurisht që mund të arrihet të sigurohet kur të tre anëtarët ndodhen në gjykatë. Por unë do ta quaja të rrezikshme që një kompetencë thelbësore të kancelarit, siç është për shembull pjesëmarrja në Këshill, sepse kancelari nuk ka vetëm të drejtën e pjesëmarrjes në Këshill me të drejtë vote, ka edhe të drejtën për shembull që të marrë vendime për statusin e nëpunësve gjyqësorë civilë. Në qoftë se ne do t'i themi kancelarit që meqenëse ti nuk je, këtë të drejtë ia delegojmë një punonjësi, një nëpunësi civil të gjykatës, do të ishte në kundërshtim me ligjin. Për këtë arsye kemi parashikuar që këtë kompetencë thelbësore të kancelarit, nëse ai nuk është ta ushtrojë një nëpunës civil më i lartë, siç kundër janë nëpunësit e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që i cakton vetë KLGJ. Vetë ligji e pranon këtë parim. Kur ai thotë që për çështje që lidhen

me nëpunësit gjyqësorë civilë, ku hetimin disiplinor sigurisht e ka ndjekur kancelari, zëvendësimin e tij në Këshill e bën pikërisht ky nëpunës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, atëherë, të njëjtin parim kemi marrë, për analogji kemi inkorporuar edhe në rastin kur kancelari mungon në një situatë normale.

Brunilda Kadi: Edhe për një arsye tjetër, që është pikërisht KLGJ ai që emëron kancelarin ose që ka përgjegjësinë për të gjithë administrimin e përgjithshëm të të gjithë gjykatave. Domethënë kjo, balancon pak a shumë atë cenimin (në thonjëza) të parimit të pavarësisë që e theksoi Brikena. Mirë është që të jetë brenda gjykatës, por në një rast ekstrem që, ideja është kur mungon 30 ditë kancelari, mbi 30 ditë, që besoj që do jetë një rast shumë-shumë i radhë... Ne e mendojmë më të balancuar që zëvendësimi të bëhet nga një nëpunës që zgjedh KLGJ-ja.

Naureda Llagami: Më fal! Kam edhe një sqarim tjetër.

Çfarë ndodh me situatën kur ne e dimë shumë mirë që në një pjesë të gjykatave sot nuk kemi kancelarë dhe janë caktuar persona të tjerë nga kryetarët e këtyre gjykatave? Keni parashikuar një dispozitë tranzitore për të rregulluar situatën e këtyre me rregullimin e ri?

Brikena Ukperaj: Kjo, në vlerësimin tim, nuk është çështje që duhet ta zgjidhë... se kjo është për rregullat, për mënyrën se si funksionon Këshilli i Gjykatës. Unë këtë thashë, që ky nëpunës gjyqësor civil, që mund të ushtrojë veprimtari administrative sepse s'ka kancelar, për shembull hedh shortin ose ushtron kompetenca të tjera që kanë të bëjnë me administrimin e veprimtarisë gjyqësore në gjykatë. Nuk mund të vijë në Këshillin e Gjykatës dhe të plotësojë kompozimin e Këshillit të Gjykatës në vend të kancelarit, kur diskutohet statusi i një nëpunësi civil dhe të gjitha kompetencat e tjera përveç rastit kur ligji e ka parashikuar në mënyrë të veçantë zëvendësimin.

Ne kishim parë edhe një mundësi që Këshilli i Lartë Gjyqësor për shembull mund të komandonte dikë ose... sepse e cakton vetë ai kancelarin në gjykatë, por nuk ka hapësirë ligjore për ta bërë.

Naureda Llagami: Atëherë, problemi që kam unë, është që nesër, me publikimin e kësaj rregulloreje, të fillojë funksionimin këshilli i gjykatave. Aktualisht, të paktën nga informacionet që kemi në kuadër të vetingut që i bëhet kancelarëve, ne e dimë shumë

mirë që në disa gjykata, personat që ushtrojnë detyrën e kancelarit, janë persona të cilët mund të jenë kryesekretarë, sekretarë. Varet si i ka caktuar kryetari. Në këtë lloj situatë, a është Këshilli i mundshëm ta ushtrojë funksionin - është pyetja - apo nuk është i mundshëm ta ushtrojë dhe do duhet që neve të autorizojmë një person/nëpunës të nivelit të lartë? Kjo është situata që kam unë sot.

Brikena Ukperaj: Me propozimin që vjen nga Komisioni, për mënyrën se si janë parashikuar rregullat në këtë rregullore është parashikuar që pikërisht për këto gjykata, Këshilli i Gjykatës funksionon vetëm pasi të caktojë Këshilli i Lartë Gjyqësor një nëpunës të lartë në këto gjykata, që të shkojë të asistojë në mbledhjet e Këshillit të Gjykatës.

Naureda Llagami: Ndonjë çështje tjetër?

Ta kalojmë për votim projekt-aktin?

Pra, do kalojmë për votim projekt-aktin me variantin e propozuar nga Komisioni, lidhur me caktimin e një nëpunësi civil gjyqësor të KLGJ, në rast se kancelari nuk mund të ushtrojë detyrën e tij për më shumë se 1 muaj.

Atëherë, kalojmë projekt-aktin në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatave”, sipas variantit të propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 20.05.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:09 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Medi Bici.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Marjana Papa, OSCE.*
- 7. Krisi Kllapi, Qendra Evropiane.*
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Alketa Vushaj, KSHH.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Charles Ericksen, USAID.*
- 13. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 14. Olta Lolo, USAID.*
- 15. Erjon Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Edhe ky projekt-akt është një projekt-akt i cili propozohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Ai përcakton rregulla të hollësishme lidhur me kriteret për dhënien nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor të lejeve

të papaguara për të gjithë gjyqtarët që ushtrojnë funksionin si pjesë e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, si dhe procedurat që ndiqen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për dhënien e këtyre lejeve. Edhe ky projektvendim është rezultat i një konsultimi të vazhdueshëm me partnerët, si EURALIUS dhe USAID, të cilët kanë dhënë një kontribut në hartimin e tij. Lidhur me detajet e projekt-aktit, fjalën po ia japim zonjës Brunilda Kadi, për ta relatuar.

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Hartimi i kësaj rregulloreje, siç del edhe nga titulli që është theksuar që në hyrje për çfarë bën fjalë, është për të përcaktuar procedurat dhe kriteret mbi të cilat do veprojë Këshilli i Lartë Gjyqësor për të miratuar lejet e papaguara të gjyqtarëve, pra janë lejet e papaguara që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, theksohet sepse lejet e papaguara mund të jepen edhe nga organet e tjera dhe kjo rregullore flet pikërisht vetëm për këto lloj lejesh. Urdhërimin, autorizimin për të bërë këtë rregullore na i jep neni 24/6 e ligjit ku thotë që Këshilli duhet të përcaktojë rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e këtyre lejeve.

Unë po ndalem në disa momente që kanë qenë të diskutueshme dhe për t'u shpjeguar edhe më tej që të kuptohet qëllimi që ne kemi menduar për të draftuar. Siç u tha edhe nga Kryetarja, në hartimin e këtij drafti, Komisioni ynë ka marrë mendimet e dy misioneve dhe të kryetarëve të gjykatave, kuptohet, ata që kanë dhënë mendim se jo se kemi pasur shumë fidbek (feedback) nga këta të fundit.

Është ndarë në kapituj rregullorja...

Më falni, se e thashë që në fillim 'rregullorja'. Është vendim. Është në formën e vendimit. Pjesa e parë është "Dispozita të përgjithshme" ku përcaktohen qëllimi dhe objekti i kësaj rregulloreje.

Në kapitullin e dytë ndahen llojet e lejeve dhe jepen përkufizimet, ku përsëri theksohet këtu që, tek pika b "Leje e papaguar" janë ato leje që nuk paguhen gjatë kohëzgjatjes së tyre dhe që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Diku është përmendur edhe Komisioni përkatës. Sipas propozimit tonë, në një moment të caktuar është Komisionit i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë që do miratojë lejet dhe në pjesët e tjera është ai që relaton për Këshillin dhe përgatit të gjithë procedurën për rastet e tjera.

Në kapitullin III përcaktohen “Parimet”. Ne e kemi vlerësuar që tre janë parimet kryesore mbi të cilat duhet të udhëhiqen edhe paraqitja e kërkesave nga ana e gjyqtarëve por edhe Këshilli në dhënien e tyre, -që janë ato që keni të shkruar dhe nuk po ndalem.

Tek llojet e lejeve janë ato që janë përcaktuar shprehimisht tek dispozitat, në kapitullin IV. Është leja prindërore; leja për qëllime kualifikimi dhe specializime në një institucion trajnimi, - dhe këtu është theksuar që është jashtë periudhës së formimit vazhdues; është leja për arsye familjare dhe shëndetësore.

Në këtë rregullore bëhet kjo ndarje për të qartësuar dallimin nga njëri tjetri, bazuar në interpretimin në tërësi të nenit 24 të ligjit 96 dhe të dispozitave të tjera të po këtij ligji, që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, si dhe ato rregullime të Kodit të Punës që kanë lidhje me këtë aspekt.

Në këtë dispozitë të rregullores, theksohet, siç thashë më lart që, lejet për qëllim kualifikimi dhe specializime në një institucion trajnimi janë ato jashtë periudhës së formimit vazhdues, se mund të ketë një moment që mund të konfondohen. Këtu sqarojmë që në lidhje me këto lloj trajnimesh dhe lejet që duhet të japë Këshilli, vlerësohet që duhet të bëhet një rregullore tjetër sipas edhe urdhërimit të nenit 5, pika 6 e ligjit 96/2016 që flet për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve për trajnimin vazhdues.

Në kapitullin e katërt, flitet për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes prindërore dhe këtu është përcaktuar i gjithë rregullimi që jep Kodi i Punës për këtë lloj leje sepse vetë ligji, autorizon që kjo lloj leje do jepet sipas Kodit të Punës. Është përsëritur pothuajse e gjithë dispozita që flet, me disa shtesa që janë vlerësuar të nevojshme nga Komisioni, që ka të bëjë më tepër me procedurën. Është vlerësuar që kjo kërkesë duhet të sillet brenda 7 ditëve, të trajtohet nga Komisioni brenda 7 ditëve dhe këtë ia kalon Këshillit, i cili brenda 15 ditëve duhet të marrë vendim. Kur miratohet kjo lloj leje, është parashikuar që Këshilli duhet të shprehet edhe se çfarë të bëhet me çështjet që ka në shqyrtim gjyqtari, për t’i rihedhur ose jo në short, kjo në varësi të periudhës së lejes që do akordohet. Gjithashtu është parashikuar edhe mundësia e refuzimit të kësaj leje, nëse cenohet funksionaliteti apo përmbushja e detyrës me efikasitet dhe Këshilli, sipas edhe rregullimeve dhe dispozitave të Kodit të Punës, thjesht mund ta shtyjë këtë akordimin e kësaj leje deri në 6 muaj.

Tek rregullimet e pjesës materiale, këtu është, siç e keni edhe në relacion, në lidhje me një lloj kufizimi që është parashikuar tek rregullorja, për lejen prindërore, tek pika c) thuhet që... më falni, është pika a), thuhet: “a) Kjo leje jepet për një periudhë jo më pak se 4 muaj dhe jo më shumë se 2 vjet në total për çdo fëmijë, derisa fëmija që ka në ngarkim të arrijë moshën 6 vjeç”. Ky kufizim propozohet nga Komisioni me shumicë votash, ku njëri nga anëtarët s’është dakord me këtë.

Në lidhje me arsyetimin që jep shumica, për ta vënë këtë kufizim, ndryshe nga ajo që jep Kodi i Punës është sepse vetë neni 24, pika 3 e ligjit, kur flet për lejet e papaguara, përcakton që këto jepen deri në 2 vjet dhe në kushtet kur edhe leja prindërore është një lloj leje e papaguar, ajo duhet të kufizohet deri në 2 vjet, ndërkohë që anëtari që është kundër - konkretisht jam unë kundër kësaj vendosjes së këtij kufiri - është arsyetimi se neni 24 i ligjit shprehimisht referon se kjo leje jepet në përputhje me Kodin e Punës dhe neni 132 i Kodit të Punës që flet për këtë leje nuk e vendos një kufizim të tillë. Paragrafi i këtij neni përcakton se punëmarrësi ka të drejtë ta marrë këtë derisa fëmija të arrijë moshën 6 vjeç, që do të thotë, potencialisht, teorikisht, kjo leje mund të merret edhe 6 vjet dhe arsyetimi është bazuar jo vetëm në nenin 4 të Kodit të Punës por edhe në nenin 24 që shprehimisht referon rregullimin e kësaj të drejte... dhe rregullorja nuk mund të cenojë standardin minimal për të drejtat e punëmarrësit të vendosura aty.

Gjithashtu, nisur edhe nga natyra e veçantë e kësaj leje duhet të kihet parasysh se këtu nuk përfshihet vetëm e drejta e gjyqtarit për të ushtruar të drejtën prindërore, por edhe interesi më i lartë i fëmijës që në një rast konkret, në një situatë specifike, mund të jetë më i rëndësishmi nga gjithçka tjetër.

Më tutje, parashikimi i kushteve kur jepet kjo leje në shkronjat /a/, /b/ dhe /c/ është thjesht përsëritja e Kodit të Punës dhe është vlerësuar një afat 30 ditë përpara kohës kur gjyqtari mendon që ta marrë këtë leje, duhet ta sjellë kërkesën. Është vlerësuar nga Komisioni që këto afate janë të përshtatshme si për gjyqtarin edhe për Këshillin dhe Komisionin për ta trajtuar kërkesën.

Për sa i përket shtyrjes deri në 6 muaj, siç i citua më lart, është bërë ky parashikimi sepse situata të tilla mund të ketë shpesh dhe Këshilli rast pas rasti duhet t’i vlerësojë gjithmonë bazuar në parimet që udhëhiqet kjo rregullore, duke i balancuar ato

me njëra-tjetrën. Pra të shihet edhe e drejta... për jetë private dhe familjare, por edhe efikasiteti dhe funksionimi i gjykatës.

Për sa i përket kritereve dhe dhënies së lejes për qëllime kualifikimi dhe specializimi është parashikuar ajo që thotë vetë dispozita. Përsëri këto procedurat, afatet, brenda të cilave duhet t'i sjellë gjyqtari dhe duhet të shprehet Komisioni dhe Këshilli, janë si ato më lart. Është vendosur, këtu është parashikuar që duhet të sjellë dokumentacionin justifikues, të dhënat për institucionin trajnues, mendimin me shkrim të kryetarit në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit, parashikime këto që i ka edhe shprehimisht ligji.

Kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për arsye familjare ose shëndetësore – është tek kapitulli tjetër. Këtu është parashikuar një rregullim i veçantë ku thuhet ‘deri në 30 ditë, sipas nenit 96, pika 2 të Kodit të Punës, pra nëse janë ato rastet që thotë shprehimisht kjo dispozitë, jepen nga kryetari i gjykatës, ndërsa kur këtë leje e kërkon vet kryetari është vlerësuar që këtë ta japë Komisioni përkatës dhe sipas përkufizimeve është Komisioni i Etikës dhe Vlerësimit. Ndërsa kur kjo leje është mbi 30 ditë deri në 2 vjet, ajo jepet nga Këshilli dhe përcaktohen pothuajse të njëjtat afate për paraqitjen, për shqyrtimin dhe dhënien e vendimit.

Në lidhje me këtë parashikim specifik që u theksua më lart është menduar për çështje praktikiteti, pra që lejet, pavarësisht se punëdhënësi është Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar termave që përdor Kodi i Punës, për çështje praktikiteti është vlerësuar që deri në 30 ditë, aq sa shpreh neni 96 i Kodit të Punës, ta japë kryetari i gjykatës. Në fakt këtu është për të diskutuar sepse kjo është e drejtë e gjyqtarit dhe nëse verifikohen kushtet, ndoshta aty ai thjesht njofton, por gjithsesi kjo kështu është vlerësuar nga Komisioni ynë për t'u paraqitur si draft.

Tek dispozitat kalimtare pastaj është parashikuar që lejet që janë dhënë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, të vazhdojnë të zbatohen sipas kushteve të vendosura në to. Ky parashikim është bërë duke vlerësuar se një disponim ndryshe do të cenonte të drejtat e tyre dhe sigurisht parimin e sigurisë juridike.

Në fund është menduar, duke e vlerësuar se është një akt kolektiv, hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje të bëhet mbas botimit në faqen zyrtare të Këshillit.

...e këtij vendimi, -më falni.

Pak a shumë këto janë.

Brikena Ukperaj: Edhe diçka, për të sqaruar.

Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë... Vendimi, rregullat që kemi miratuar...

Vendimi ka për qëllim të përcaktojë rregulla të hollësishme për mënyrën dhe për procedurën që ndiqen vetëm për lejet e papaguara që jep Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pra nuk ka objekt për shembull lejet e veçanta, sepse shumica e kryetarëve të gjykatave kanë qenë të preokupuar nëse duhet rregulluar apo duhet të përbëjë objekt rregullimi tek kjo rregullore lejet e veçanta që japin kryetarët. Jemi në dijeni që edhe për shkak të shfuqizimit të një pike të nenit 23 tek lejet e paguara, ka një mungesë ose konfuzion ligjor lidhur me rastet se kur kryetari duhet të japë leje, kur duhet të japë leje Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Ajo që ligji detyron Këshillin e Lartë Gjyqësor të miratojë, janë vetëm rregullat dhe procedurat për mënyrën e dhënies së lejes së papaguar. Pra nuk ka të bëjë kjo, nuk ndërhyr kjo rregullore në kompetencat e kryetarit për të dhënë leje të veçanta, të cilat sigurisht mund të parashikohen në pjesën e rregulloreve që mund të bëjnë vet gjykatat, sipas orientimeve/vendosjes së rregullave që do të përcaktojë Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Nuk duhet konfunduar gjithashtu që leja për qëllime specializimi dhe trajnimi që jep Këshilli i Lartë Gjyqësor deri në 2 vjet, kjo është një leje e papaguar. Nuk është leje e paguar dhe ndryshon nga leja që mund të kërkojë gjyqtari për të marrë pjesë në trajnimin vazhdues sepse deri në 40 ditë në vit, gjyqtari ka të drejtën që të ndjekë programin e trajnimit vazhdues brenda ose edhe jashtë vendit. Kjo është një leje që Këshilli i Lartë Gjyqësor e miraton paraprakisht të themi, në momentin kur ai miraton edhe gjithë programin dhe mënyrën se si organizohet trajnimi vazhdues nga Shkolla e Magjistraturës. Në këtë rast bëhet fjalë për leje që mund të kërkojë gjyqtari tej kësaj periudhe, të cilat mund të shkojnë sipas ligjit deri në 2 vjet. Është parashikuar e gjithë procedura, të gjitha kriteret që duhen për miratimin e kësaj leje, mënyrën se si gjyqtari e njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor, e gjithë procedura që ndjek Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe afatet e shkurtra janë pikërisht për të respektuar shpejtësinë dhe për t'i dhënë mundësi gjyqtarit që të ndjekë trajnimin.

E diskutueshme mund të ishte fakti nëse duhet që të përfshihet, që të jetë objekt diskutimi në mbledhje plenare apo mund të vendosë Komisioni. Duke marrë parasysh që ligji ngarkon Këshillin dhe duke marrë parasysh që mund të bëhet fjalë për leje afatgjata, kemi vlerësuar që kjo është kompetencë e mbledhjes plenare. Kjo për sa i përket lejeve për qëllime kualifikimi ose trajnimi jashtë shtetit.

Për sa i përket lejes prindërore. Leja prindërore, mënyra se si janë konceptuar rregullat në këtë vendim është parë e lidhur ngushtë me dispozitat e Kodit të Punës. Parismisht leja prindërore është një leje që nuk mund t'i refuzohet gjyqtarit ose çdo punëmarrësi që e kërkon dhe që është në kushtet e Kodit të Punës. Punëdhënësi me punëmarrësin në marrëveshje, -thotë Kodi i Punës, -mund të përcaktojnë vetëm kohëzgjatjen e kësaj leje, të cilën gjyqtari mund ta marrë derisa fëmija të bëhet 6 vjeç.

Shumica në Komision ka vlerësuar që afati brenda të cilit gjyqtari mund të kërkojë lejen prindërore, nuk nënputkon afatin maksimal për të cilin mund të jepet kjo leje. Kodi i Punës parashikon që punëmarrësi dhe punëdhënësi duhet të ketë marrëveshje për të përcaktuar kohëzgjatjen e lejes prindërore. Duke marrë parasysh këtë parashikim, duke marrë parasysh edhe parashikimin e nenit 24 që për leje të tjera të papaguara, vendos tavanin 2 vjet, kemi vlerësuar që edhe për rastin e gjyqtarit, leja prindërore nuk mund të kalojë afatin 2-vjeçar për çdo fëmijë sepse mund të ndodhë që gjyqtari ta kërkojë lejen për fëmijën e dytë ose për fëmijën e tretë, prandaj është vendosur afati 2-vjeçar dhe nuk është lënë e hapur se sa mund të jetë afati brenda të cilit mund të jepet kjo leje. Ajo që parashikon ligji dhe që parashikon dispozita është fakti që Këshilli mundet që të shtyjë afatin e kërimit të lejes për të ruajtur efektivitetin dhe funksionalitetin e veprimtarisë gjyqësore. Pra në qoftë se gjyqtari do të kërkonte një leje prindërore për 2 vjet, do të fillonte nga muaji janar, deri në 6 muaj Këshilli ka të drejtë që të thotë okej, lejen do ta marrësh, por në qoftë se plotëson kushtet, mund ta fillosh në mars. Këtë gjë parashikon ligji. Pra ti ke të drejtën që të shtysh afatin por nuk mund t'ia refuzosh gjyqtarit.

Ndërsa për lejen për arsye familjare dhe shëndetësore është interpretuar neni 24 në përputhje me nenin 96 të Kodit të Punës, është parashikuar, siç kundër tha edhe Bruna, e gjithë procedura, afati, kjo leje edhe mund të refuzohet, gjithmonë duke ruajtur sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetën private dhe familjare, pa

cenuar dhe përmbushjen e funksionit në efikasitet dhe në kohë, ndërkohë që deri në 30 ditë është ndjekur logjika që ashtu sikundër çdo punëmarrës tjetër, në qoftë se do kërkonte një leje familjare/shëndetësore të papaguar, të vërtetuar gjithmonë në qoftë se është leja shëndetësore me raport mjekësor, mund ta kërkojë pranë kryetarit të gjykatës, për të mos u investuar Këshilli në leje 2-ditore, 3-ditore, 4-ditore, 10-ditore, 15-ditore. Për kryetarin e gjykatës është vlerësuar që këtë leje ta japë Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Në rastin e lejes tej 30 ditë, atëherë investohet Këshilli dhe është autoriteti që jep lejen e papaguar.

Nuk e di nëse ka edhe Erjoni diçka tjetër për të shtuar?!

Erjon Muharremaj: Jo!

Alban Toro: Kemi krijuar një standard të caktuar në këtë Këshill që, të gjithë vendimmarrjet do të kalonin nëpërmjet Këshillit, të çfarëdo lloj natyre, të çfarëdo lloj karakteri. Personalisht kam qenë kundër sepse shikoj hapësirat në legjislacion që edhe Komisioni mund të ketë të drejtë. Megjithatë, shumica e ka krijuar këtë standard. Do të ishte mirë që këtë standard ta respektonim dhe të pasqyrohej edhe këtu, të paktën, për sa i përket, tek kryetari i gjykatës, ku i keni deleguar Komisionit. Kemi pasur kryetarë gjykate që kanë qenë si ministra të jashtëm. Nuk e di sa do ta përballojë Komisioni këtë peshë. Kështu që, do të ishte mirë që edhe për respekt të sigurisë juridike, ta ruanim dhe ta reflektojmë edhe këtë në vendimmarrjen e Këshillit.

Brikena Ukperaj: Bëhet fjalë për leje deri në 30 ditë.

Alban Toro: Për 30 ditë. Për 30 ditë.

Për çdo gjë kemi thënë e ka Këshilli, jo Komisioni.

Përjashtoj, rasti i vetëm ka qenë ai me vetingun. Diçka e tillë domethënë, që raporti kalon nëpërmjet Komisionit. Ai rast ishte rast specifik u tha, sepse për vetë karakterin që kishte. Rast tjetër unë nuk di, përpos atij që ka ligji për ankimin ndaj arkivimit të ankimeve.

Brikena Ukperaj: Atëherë, është diskutuar në Komision nëse duhet t'ia linim edhe këtë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhjes plenare sepse Këshilli punën e ka edhe me mbledhjen plenare edhe me komisionet. Komisionet nënkupton edhe Këshillin, nuk nënkupton vetëm mbledhjen plenare të Këshillit.

Unë vazhdoj t'i qëndroj mendimit që edhe Komisionet janë vendimmarrëse, pavarësisht debateve që ekzistojnë, por për ta bërë më efektive, më të shpejtë, duke qenë se bëhet fjalë për një leje 30-ditore, vlerësuam që mund ta mbajë Komisioni. Megjithatë, nëse mendoni që edhe kjo leje 30-ditore për kryetarët, të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, le të kalojë si propozim në votim dhe ta vendosi mbledhja.

Erjon Muharremaj: Jam dakord me preokupimin që ka zoti Toro në lidhje me ruajtjen e parimit të sigurisë juridike dhe në vijim të asaj që tha kolegja Ukperaj, ne gjykuam për efekt të shpejtësisë në vendimmarrje. Propozuam që vendimin ta merrte Komisioni. Ndërsa, në lidhje me merakun që keni juve që, nëse Komisioni e ka të mundur ta përballojë këtë ngarkesë, neve e diskutuam që të tre anëtarët dhe besojmë që e kemi kapacitetin për ta mbajtur këtë lloj ngarkese dhe nuk kemi asnjë problem në lidhje me këtë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë koment tjetër?

Atëherë, të kalojmë në votim propozimin e bërë nga Komisioni, më pas të kalojmë në votim propozimin e bërë nga...

Brikena Ukperaj: Unë do të propozoja që fillimisht të kalojë propozimi që bëri zoti Toro, që lejen për arsye shëndetësore dhe familjare për kryetarin e gjykatës, në qoftë se ai e kërkon për një periudhë deri në 30 ditë, ta japë mbledhja plenare dhe jo Komisioni, domethënë Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare dhe jo Komisioni.

Brunilda Kadi: Atëherë, përveç propozimit të zotit Toro, që është ndryshe nga projekti, unë mendoj që duhet të hidhet fillimisht edhe në lidhje me propozimin që bëra unë për mos vendosjen e afatit 2-vjeçar, pra që thjesht të hiqet afati 2-vjeçar dhe të lihet siç është në Kodin e Punës. Pra mendoj që të hidhen fillimisht këto dy propozime që janë ndryshe nga drafti.

Fatmira Luli: Unë mendoj që atë e ka zgjidhur Kodi i Punës dhe ligji. Në dispozitat e përgjithshme të Kodit të Punës thuhet që nëse nuk përcaktohet me ligj të posaçëm, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës. Dhe ligji për qeverisjen vendore ka caktuar afat për lejet e papaguara deri në 2 vjet. Kështu që them, s'është rregullorja. Kodi i punës abstenon kur ke ligj të posaçëm. Thotë që nuk rregulloj kur janë të rregulluara të përcaktuara afatet me ligj të posaçëm, siç është ligji "Për statusin" dhe "Nëpunësin civil"

që ka rregullime të tjera veç Kodit të Punës. E ke në dispozitat në nenin 2 të përcaktuar. Ligjin “Për ushtarakun...”. Të tëra këto janë raste, nëse ligji i posaçëm nuk parashikon një rregullim, atëherë zbatohet Kodi i Punës dhe kjo është e zgjidhur, nuk përbën asnjë lloj konflikti.

Brunilda Kadi: Atëherë, thjesht zonja Luli po ju theksoj, neni 24, paragrafi i parë thotë: “Leja prindërore jepet në përputhje me Kodin e Punës”, -ta thotë shprehimisht.

Pastaj, më lejoni t’ju jap një rast. Larg Zotit, mos ndodhtë kurrë. Por lind fëmija dhe nëna vdes në lidhje. I vetmi prind është babai që është gjyqtar. Më falni, mund t’ia refuzoni atij lejen të kërkojë leje deri në 6 vjet, derisa të bëhet 6 vjeç fëmija ose larg qoftë fëmija është i sëmurë, mundet juve t’ia kufizoni këtë deri në 2 vjet? Sepse Kodi i Punës është standard minimal dhe është sipas direktivave të BE-së dhe të Konventave të ILO-s.

Fatmira Luli: Unë mendoj që s’do ta kërkojë vetë ai 6 vjet sepse ai duhet të ushqejë kalamanin dhe i duhet që të punojë dhe të mbajë familjen me para. Unë them që ky është një rast që s’ka për t’u zbatuar kurrë. Afti 2-vjeçar është afati më i arsyeshëm.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Marrë shkas nga debati.

A mundet që të përcaktohet si përjashtim, se ai rasti që thotë Bruna është një përjashtim, që të konsiderojë Këshilli në rastet tej përjashtimore dhënien e një leje përtej afatit 2-vjeçar, në varësi të situatës konkrete që mund të ketë.

(Zoti Toska flet një moment pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Ilir, do jetë propozim tjetër ky?

Është propozimi i tretë?

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Maksim Qoku: Më lejo të them diçka edhe unë.

Mbase të vijmë në një... sepse jam edhe me Brunën edhe me Ilirin, çka do të thotë, detyrimisht jemi të detyruar të përcaktojmë rregullin dhe ai e bart vet përjashtimin. Ne si rregull, duke qenë dhe organ ekzekutiv, na shqetësojnë problemet e sistemit dhe normalisht duhet të jemi në kontakt me të gjithë problematikën që sjell, mendoj që do duhet të vëmë një afat. Afti 2-vjeçar në atë analogji që bëmë është logjik. Por përjashtimisht na duhet që rast pas rasti, për sa ligji specifik Kodi i Punës nuk ka vënë

afat dhe ka parashikuar një marrëveshje midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, në rastin konkret midis gjyqtarit dhe Këshillit, përjashtimisht ne na duhet që për rastet e kësaj natyre, Këshilli mund që ta çmojë kërkesën e bërë nga ai gjyqtar dhe të vendosë për afat jashtë këtij 2-vjeçarit. Prandaj jam me logjikën e rregullit dhe një përjashtimi.

(Disa nga anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

E para, vendimmarrja jonë mund të rrëzohet nga gjykata. Nuk është problem ajo... ne e bëjmë përjashtimisht.

Brunilda Kadi: Si do e bësh përjashtimisht ti kur ta thotë Kodi? Si mund të cenojë rregullorja Kodin e Punës?

Maksim Qoku: Kodi thotë 'marrëveshje'.

Brunilda Kadi: Mirë pra 'marrëveshje'. Por ti në qoftë se vendos kufizimin...

Maksim Qoku: Marrëveshje pa një afat të caktuar dhe duhet ta bëjë punëmarrësi midis punëdhënësit, çka do të thotë, në aspektin konkret, KLGJ-ja me gjyqtarin. Dhe në qoftë se do të jetë e nevojshme rasti...

Brunilda Kadi: Pra i jep vetes diskrecion mbi Kodin.

Maksim Qoku: Që të bëjmë një marrëveshje, diskrecion? Po s'ka vënë Kodi afat.

Brunilda Kadi: I ka dhënë pra, 6 vjet, -thotë Kodi.

Maksim Qoku: 6 vjet është afati tavan. Brenda 6 viteve e kemi marrëveshjen.

Brunilda Kadi: Me ç'të drejtë do ta ulësh ti?

Maksim Qoku: Nuk ul gjë. Do ta çmojmë rast pas rasti, se thotë deri në 6 vjet.

Po, nëse thuhet deri në 6 vjet, është afat tavan. Nuk kufizojmë gjë.

Duhet të na kuptosh. Jemi në logjikën tënde.

Neve rastin tënd e marrim parasysh. Nëse do duhet që deri në 6 vjet t'ia japim, 6 vjet do ia japim. Kjo është logjika.

Brikena Ukperaj: Interpretimi që bën secili është personal.

Kodi në asnjë vend nuk thotë që leja prindërore jepet deri në 6 vjet. Kodi thotë që ti ke të drejtë të marrësh leje prindërore derisa fëmija të bëhet 6 vjeç.

Të lutem, Bruna, nuk të ndërpreva.

Kodi thotë edhe një gjë tjetër. Kohëzgjatja e kësaj leje bëhet nëpërmjet marrëveshjes midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Ky është rregullim i përgjithshëm,

standard. Kalojmë tek ligji i posaçëm. Çfarë thotë ligji i posaçëm? Ligji i posaçëm thotë që Këshilli i Lartë Gjyqësor jep leje prindërore sipas Kodit të Punës. Kaq. Dhe thotë, kjo leje prindërore është e papaguar. Domethënë, gjyqtari nuk paguhet gjatë kësaj leje, por me efektin që vendi do t'i ruhet gjyqtarit. Apo jo? Thamë që këtë të drejtë ta ketë për çdo fëmijë. Thamë që kjo leje nuk mund të refuzohet.

Brunilda Kadi: Brikena, nuk e themi ne këtë, e thotë Kodi i Punës. Nuk po japim të drejta. E thotë Kodi i Punës. Është standard minimal.

Brikena Ukperaj: Po i rendis të gjitha ato të drejta që jep leja prindërore gjyqtarit. Mendo, në qoftë se shumica e gjyqtarëve do vijnë të kërkojnë leje prindërore vetëm se kanë një fëmijë, kanë dy apo tre. Më kupton? Prandaj kohëzgjatja është kjo: deri në 2 vjet maksimumi si çdo pushim tjetër i papaguar edhe leja prindërore të shkojë nga 4 muaj në 2 vjet. Në fund të fundit janë disa rregulla që ne kemi të drejtë t'i vëmë sepse kështu do fillojmë me çdo gjyqtar do bëjë marrëveshje KLGJ-ja? Kjo ishte.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Atëherë, po them edhe këtë tjetren. Nuk ka ardhur asnjë gjyqtar me këtë arsyetim që the ti, që ne ta parashikojmë.

Brunilda Kadi: Unë thashë, larg qoftë, o Zot mos ndodhtë kurrë.

Brikena Ukperaj: Pikërisht pra.

Brunilda Kadi: Por t'i s'mund ta kufizosh të drejtën që ia ka dhënë minimalisht Kodi. Nuk mund ta kufizosh. Këtë po them.

Brikena Ukperaj: Ne kemi interpretime të ndryshme të ligjit.

Brunilda Kadi: Kryetare, meqenëse unë e propozoj, hidheni variantin që propozoj unë, pra që të hiqet fare kufizimi, pastaj kalojmë me... Që të mos marrim kohë njëri me tjetrin, në qoftë se s'ka diskutim tjetër.

Ilir Toska: A mund të na japë një opinion Komisioni për këtë që unë thashë, bashkë me Maksin, për të vendosur një përjashtim. Bën sens brenda rregullores apo është pa sens?

(Anëtarët diskutojnë pak minuta pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Atëherë, për të vijuar miratimin e projekt-aktit, do hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Kadi, sipas të cilit të ruhet standardi i parashikuar në Kodin e Punës duke mos vendosur kufizim deri në 2 vjet, në pikën 5, shkronja /a/.

Kalojmë në votim projekt-aktin me propozimin e bërë nga zonja Kadi?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Hedhim në votim variantin e propozuar nga zoti Toska, ku në pikën 5 të projekt-aktit, shkronja /a/, të shtohet fjalia, pas fjalisë së parë, ku thuhet: "...për një periudhë jo më pas se 4 muaj dhe jo më shumë se 2 vjet në total për çdo fëmijë, derisa fëmija që ka në ngarkim të arrijë moshën 6 vjeç. ***Përgjashtimisht për raste të rënda dhe të motivuara, ky afat mund të zgjatet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.***"

Jemi dakord me propozimin?

Kalojmë në votim projekt-aktin me propozimin e bërë nga zoti Toska?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Dritan Hallunaj: Atëherë, unë kam edhe një propozim tjetër, përveç asaj që thotë zoti Toro, pasi personalisht jam që lejen deri në 30 ditë për kryetarin e gjykatës duhet ta bëjë Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nuk është e nevojshme që ta ketë Komisioni. Kjo ka qenë edhe tradita që është ndjekur më përpara, që gjithmonë, lejet për një afat të caktuar i ka dhënë Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kështu që unë çmoj që të jetë.. domethënë, kam një propozim tjetër që të lihet si tagër që ta ketë Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor lejen 30 ditë për kryetarin e gjykatës.

Alban Toro: Tani, po na tregove edhe bazën ligjore, e tërheq unë pastaj.

Fatmira Luli: Kompetencat e Kryetarit janë të përcaktuara.

Naureda Llagami: Atëherë, lidhur me pikën 7, propozimi i bërë nga zoti Toro është që leja të jepet jo nga Komisioni por nga Këshilli. Jemi dakord me propozimin e dhënë nga zoti Toro?

Kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Pro.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Nuk miratohet.

Atëherë, kalojmë tek propozimi i dytë i bërë nga zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Tërhiqem nga propozimi.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim të gjithë projekt-aktin së bashku me propozimet e miratuara.

Maksim Qoku: Pro.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Projekt-akti miratohet sipas propozimeve të miratuara.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 20.05.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:09 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Medi Bici**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.**
- 6. Marjana Papa, OSCE.**
- 7. Krisi Kllapi, Qendra Evropiane.**
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 9. Alketa Vushaj, KSHH.**
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.**
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 12. Charles Ericksen, USAID.**
- 13. Valbona Bala (Pajo), USAID.**
- 14. Ota Lolo, USAID.**
- 15. Erjon Fejzulla, USAID.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës, çështja e tretë lidhet me përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve

gjqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Ky projektvendim erdhi si pasojë e kërkesave të parashtruara nga gjyqtarët respektiv {...} dhe {...} për përjashtimin e tyre nga procesi i delegimeve për shkaqe shëndetësore. Gjyqtarët kanë paraqitur kërkesat e tyre të motivuara dhe të shoqëruara me aktet e nevojshme që vërtetojnë gjendjen e tyre shëndetësore.

Për më shumë detaje, lidhur me relatimin e projekt-aktit, ia jap fjalën zotit Toska, kryetar i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, siç u tha edhe nga Kryetarja e Këshillit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë paraqitur dy kërkesa nga gjyqtarët {...} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe {...} e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, përmes të cilave kanë kërkuar përjashtimin nga caktimi i tyre për çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Kërkesave të tyre ata i kanë bashkëlidhur edhe akte mjekësore, që vërtetojnë gjendjen e tyre shëndetësore. Në rastin e zonjës Shkreli ka edhe një akt të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që bën fjalë edhe për gjendjen shëndetësore të fëmijës së saj, ku përveç diagnozës, referohet edhe nevoja për kujdes të detyrueshëm ndaj fëmijës, referuar edhe vetë moshës së tij.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, referuar vendimit të tij me nr. 30, të datës 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, konkretisht Kreu VIII, pika 6, ku thuhet se: “6. Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për arsye shëndetësore, mund të vendosë përjashtimin gjer në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta”, ka propozuar përjashtimin e gjyqtarit {...}, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6-mujor dhe po ashtu, përjashtimin e gjyqtarës {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6-mujor. Kemi përcaktuar edhe momentin kur vendimi hyn në fuqi me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pra që nga ky

moment, nëse miratohet, vendimi hyn në fuqi dhe duhet të konsiderohet në procedurat vijuese. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë koment, sugjerim për projekt-aktin e propozuar?

Kalojmë projekt-aktin për votim.

Jemi dakord me propozimin e dhënë nga Komisioni për projekt-aktin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës, duke përjashtuar për një periudhë 6-mujore, gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta dhe gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, edhe këtë për një periudhë kohore 6-mujore.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 20.05.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:09 dhe mbaroi në orën 12:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Medi Bici.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 6. Marjana Papa, OSCE.*
- 7. Krisi Kllapi, Qendra Evropiane.*
- 8. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Alketa Vushaj, KSHH.*
- 10. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Charles Ericksen, USAID.*
- 13. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 14. Olta Lolo, USAID.*
- 15. Erjon Fejzulla, USAID.*
- 16. Arben Llangozi, Jurisprudenca.*
- 17. Orgesa Serani, Jurisprudenca.*

RENDI I DITËS:

4. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e fundit e rendit të ditës.

Siç jeni në dijeni, pranë Këshillit janë mbledhur disa kërkesa për caktimin e disa gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Para se të fillojmë me shqyrtimin e projekt-aktit, kanë shprehur interesin që të ndjekin procedurën e caktimit të gjyqtarëve, përfaqësues të emisionit investigativ “STOP”.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes dy përfaqësuesit e lartpërmendur.)

Duke vijuar me rendin e ditës, kalojmë në çështjen 4 të këtij rendi që është: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Për ndjekjen e procedurës dhe hedhjen e shortit, fjalën ia kaloj kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Përpara se të kalojmë në procedurat e shortit për kërkesat që është paraqitur nevojë në gjykata të ndryshme, ju bëj me dije një tablo të përgjithshme. Numri total i gjykatave në nevojë që kanë paraqitur kërkesë është 21 (4 janë gjykatat administrative të shkallës së parë, 11 gjykata të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe 6 gjykata apeli, nga të cilat njëra me juridiksion të posaçëm). Në total janë paraqitur 67 kërkesa dhe kërkohet përmes tyre caktimi i 91 gjyqtarëve. Nga këto, 34 kërkesa janë nga gjykatat e shkallës së parë për 41 gjyqtarë dhe 33 kërkesa nga gjykatat e apelit për 50 gjyqtarë. Gjykatat që kanë paraqitur më shumë nevojë janë Gjykata e Apelit Korçë (15 kërkesa – gati gjysma e totalit të kërkesave të gjykatave të apelit), si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin (9 kërkesa – gati 1/3 e kërkesave të gjykatave të shkallës së parë). Gjykatat që kanë paraqitur në mënyrë permanente një numër jo të vogël kërkesash, përveç dy gjykatave si më lart, janë edhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjirokastrë dhe Krujë. Ndërkohë në procedurat, në propozimet që kemi bërë për procedurat e sotme të përzgjedhjes së gjyqtarëve për caktimin në çështjet gjyqësore të veçanta është mbajtur parasysh veçanërisht ekonomizimi i burimeve njerëzore, duke konsideruar procedurat e mëparshme të shortit. Kjo sa i përket të dhënave të përgjithshme.

Në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen ditën e sotme, keni një relacion bashkëlidhur materialeve të çështjes, ku kemi propozuar për radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave, fillimisht gjykatat e apeleve sipas kësaj radhe, fillimisht Gjykata e

Apelit për Krimet e Rënda, pastaj gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht: Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe në fund Gjykata e Apelit Vlorë.

Më tej vijojmë me gjykatat e shkallës së parë sipas kësaj radhe: fillimisht gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksionit të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm. Fillimisht gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e gjykatës së apelit. Këtu fillimisht me Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë, pastaj Kurbin dhe në fund Mat. Më tej vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër. Fillimisht Gjykata e Apelit Lezhë dhe më pas Tropojë. Më tej vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, fillimisht Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, më pas Sarandë dhe në fund Përmet. Më tej vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës. Fillimisht Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Kavajë dhe më pas Elbasan. Dhe në fund janë gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Pogradec.

Të fundit janë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, sipas kësaj radhe: fillimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, më pas ajo e Korçës, më pas ajo e Shkodrës dhe në fund Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Ju ftoj që të votoni për radhën e procedurave të shortit që duhet të ndjekim, nëse jeni dakord apo jo.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga Komisioni, nëse jemi dakord me radhën e procedurave të shortit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Mirë atëherë, duhet të vazhdojmë me procedurat për çdo gjykatë.

Atëherë, procedura e parë është ajo për çështjen në nevojë që ka paraqitur **Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda**. Është 1 çështje e vetme. Nuk mund të zbatohet mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në këtë skemë. Po kështu është e padobishme të zbatohet mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve, për sa kohë bëhet fjalë për 1 çështje gjyqësore të veçantë. Në këtë rast, kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, kemi vënë dy variante, varianti i parë është: Gjykata e Apelit Tiranë, referuar në këtë rast afërsisë gjeografike të kësaj gjykate me gjykatën në nevojë, ndërsa varianti i dytë është: të gjitha gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm. Ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë të jetë aq sa kërkohet nga gjykata në nevojë. Do t'ju ftoja të votonit nëse do duhet që të procedojmë sipas variantit të parë apo variantit të dytë. Varianti i parë ka një numër të kufizuar gjyqtarësh, ndërsa në variantin e dytë, baza e gjyqtarëve të përfshirë në short është më e madhe. Ne si Komision mbështesim variantin e dytë që kemi propozuar. Por gjithsesi këtë duhet ta votojë Këshilli.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim variantin e parë, pra që është vetëm Gjykata e Apelit Tiranë.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Kalojmë tek varianti i dytë, i cili do përfshihen në short të gjithë gjyqtarët e të gjithë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Vijojmë me procedurën.

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Toska: Vijojmë me procedurat e shortit sipas këtij varianti.

Referuar këtij varianti kemi propozuar edhe përjashtimet nga shorti. Përjashtimet nga shorti sipas variantit të dytë. Janë propozuar të përjashtohen nga shorti kryetarët e gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht zoti {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}...

(Zoti Toska ndez mikrofonin.)

Po kështu kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti edhe dy anëtarët e KED-së që janë zotërinjtë {...} dhe {...}. Po kështu përjashtohen nga shorti 2 gjyqtarët që i është akorduar leja afatgjatë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë: {...}, {...}. Po kështu, për shkak të lëndës së çështjes të gjykatës në nevojë kemi propozuar të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ndërsa gjyqtarët e të gjithë gjykatave të tjera me juridiksion të përgjithshëm nuk janë të profilizuar në një seksion, janë në dy seksionet. Për Gjykatën e Apelit Tiranë ka një specifike, që gjyqtarët janë të ndarë në dy seksione të veçanta. Po kështu, kemi propozuar që të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtari {...}, i cili është në prag të mbushjes së moshës së pensionit (del në pension pas 2 muajsh). Kemi propozuar gjithashtu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e

Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër, Konkretisht zoti {...}, {...} dhe {...}, kjo për shkakun se të tre këta gjyqtarë janë në procedim penal përpara juridiksionit të gjykatave të krimeve të rënda. Paraprakisht do duhet të votoni lidhur me propozimet për përjashtimet që referova më lart.

Naureda Llagami: Atëherë, jeni dakord lidhur me propozimet për përjashtimet bërë nga kryetari i Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Referuar edhe përjashtimeve, numri i gjyqtarëve që janë në juridiksion të përgjithshëm të apeleve, duhet të identifikojmë të gjithë gjyqtarët që duhet të marrin pjesë në short, duke filluar nga Gjykata e Apelit Tiranë: {...}, {...}.

Naureda Llagami: Të lutem, për efekt, drejtoje edhe tek publiku.

Ilir Toska: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me Gjykatën e Apelit Durrës që janë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me Gjykatën e Apelit Gjirokastrë: {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me Apelin e Shkodrës: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me Apelin e Vlorës: {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me Apelin Korçë: {...}, {...} dhe {...}.

Janë të gjitha emrat e gjyqtarëve në një enë. Vazhdojmë me përzgjedhjen e tyre.

{...} është emri i gjyqtarit të përzgjedhur për gjykimin e çështjes në nevojë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Me kaq mbyllet kjo procedurë shorti për këtë gjykatë. Vazhdojmë për **Gjykatën e Apelit Korçë**. Është paraqitur kërkesë për 15 çështje gjyqësore nga të cilat 9 çështje penale dhe 6 çështje civile. Kemi propozuar që për çështjet penale, pra për 9 çështjet penale, gjyqtarët të caktohen nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen të jetë 2. Kemi propozuar dy variante në funksion të shortit që do ndiqej për Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda. Kështu që bëhet efektiv edhe varianti i parë, ku kemi propozuar që për ekonomizim të burimeve njerëzore, të konsiderohet shorti i datës 18.03.2019 përmes të cilit janë përzgjedhur 2 gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë. Konkretisht zonja {...} dhe zoti {...} të cilët janë deleguar për dy apo tre çështje, të konsiderohet përsëri për të shpërndarë edhe 9 çështjet e tjera gjyqësore që është në nevojë aktualisht Gjykata e Apelit Korçë. Ndërsa sa i përket 6 çështjeve civile, kemi propozuar që gjykata nga duhet të caktohet, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër. Edhe në këtë rast kemi konsideruar për efekt të ekonomizimit të burimeve njerëzore, të konsiderohet shortet e hedhura më herët. Në shortet e hedhura më herët janë deleguar/caktuar 6 gjyqtarë të kësaj gjykate në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin, ndërsa kanë mbetur pa caktuar 3 gjyqtarë të kësaj gjykate, të cilët Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë kësaj periudhe nuk i ka caktuar në asnjë nga çështjet gjyqësore ku ka pasur nevojë. Kemi propozuar që gjyqtarët që duhet të shqyrtojnë 6 çështjet civile të jenë këta tre gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Shkodër të cilët nuk kanë marrë ngarkesë në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin. Ju ftoj të votoni nëse jeni dakord me këto propozimet e Komisionit dhe me tej të bëjmë procedurat.

Naureda Llagami: Jemi dakord me propozimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Mirë atëherë, vijojmë me procedurat për 9 çështjet penale. Nga këto 9 çështje penale, çështjet 1, 2, 3, 4, 7 dhe 8 kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Referuar miratimit të propozimit më herët, për të gjashtë këto çështje konsiderohen të caktuar nga shorti gjyqtarët {...} dhe {...}. Ndërkohë për çështjet 4 (*lapsus numri i çështjes, është nr. 6*), 5 dhe 9 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari duhet të ndjekim procedurat e shortit për përzgjedhjen mes dy gjyqtarëve si më lart. Atëherë, do të fusim në një enë çështjen nr. 4 (*lapsus numri i çështjes, është nr. 6*), 5 dhe 9. Në një enë tjetër emrat e dy gjyqtarëve {...} dhe {...}.

Emri i parë i përzgjedhur i gjyqtarit është {...}.

Do përzgjedhim çështjen ku duhet të caktohet ai - Çështja nr. 5.

Për gjyqtaren tjetër që është {...} do të përzgjedhim çështjen ku duhet të caktohet - Çështja nr. 4. (lapsus numri i çështjes, është nr. 6)

Ndërkohë që për çështjen nr. 9 përzgjedhim mes emrave të dy gjyqtarëve {...} dhe {...}. Emri i përzgjedhur është {...}. Pra për çështjen nr. 9 përzgjidhet me short {...}.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për çështjet penale dhe vijojmë procedurat për 6 çështjet civile, që janë çështjet nr. 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15. Atëherë, për çështjen nr. 11 kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve. 3 gjyqtarët që u miratuan më herët nga Këshilli, pra gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} të konsiderohen të caktuar nga shorti për gjykimin e çështjes civile nr. 11 dhe në këtë rast do të duhet të ndjekim procedurat e shortit për përcaktimin e gjyqtarit relator mes këtyre tre gjyqtarëve, pra mes gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Duhet të përzgjedhim njërin prej tyre i cili të caktohet relator për çështjen civile nr. 11 – Është {...}.

Çështjen civile nr. 12 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen 2 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër që nuk janë përzgjedhur si relatorë për gjykimin e çështjes nr. 11. Pra automatikisht, ndërsa si relator për çështjen nr. 11 u përzgjedh gjyqtari {...}, për çështjen nr. 12 dy anëtarët që janë {...} dhe {...} caktohen për çështjen nr. 12.

Për çështjen civile nr. 10, 13, 14 dhe 15 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, kemi propozuar që të përzgjidhen me short ndërmjet 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër të caktuar për çështjen nr. 11, pra mes gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Kështu që në një enë do të fusim emrat e 3 gjyqtarëve, ndërsa në enën tjetër numrat e 4 çështjeve, 10, 13, 14 dhe 15.

Do përzgjedhim emrin e gjyqtarit dhe më pas numrin e çështjes.

Emri i parë është {...}. Përzgjedhim një çështje – Çështja nr. 15.

Përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}. Përzgjedhim një çështje – 13.

Emri i tretë i gjyqtarit është {...}. Përzgjedhim një çështje – Çështja nr. 10.

Atëherë, ka mbetur dhe çështja nr. 14. Do të fusim në enë emrat e 3 gjyqtarëve ku do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre, që do të caktohet për gjykimin e çështjes nr. 14 – Atëherë është {...} emri i përzgjedhur për gjykimin e çështjes nr. 14. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë procedurat për **Gjykatën e Apelit Shkodër**.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjykata e Apelit Shkodër ka paraqitur kërkesë për 6 çështje gjyqësore (4 çështje penale dhe 2 çështje civile). Kemi propozuar që gjykatat nga duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Ndërsa nr. i gjyqtarëve që duhet të caktohet për 6 çështjet gjyqësore të jetë 3 ose 4 në varësi të shortit. Jeni dakord me këtë propozim?

Naureda Llagami: Kalojmë në votim propozimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Ndërsa u miratua propozimi si më lart, për ekonomizim të burimeve njerëzore, në këtë rast kemi propozuar të konsiderohet shorti i datës 19 shkurt, 18 mars dhe 19 prill përmes të cilave janë përzgjedhur 3 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} si dhe 3 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht zonja {...}, {...} dhe {...}.

Kemi konsideruar që emrat e gjyqtarëve nga duhet t'i përzgjedhim për përcaktimin e çështjeve në nevojë aktualisht në Gjykatën e Apelit Shkodër të jenë mes emrave të këtyre 6 gjyqtarëve. Që të mos detyrojmë të caktojmë gjyqtarë të tjerë, ndërsa numri i çështjeve është i kufizuar sikundër dhe numri i çështjeve të cilët ata janë caktuar më herët është i kufizuar. Pra, për të bërë dhe ekonomizim të burimeve njerëzore. Jeni dakord me këtë propozim?

Naureda Llagami: Kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Për çështjen civile nr. 5 në të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari {...} që është në përbërje të trupit gjykues nga gjykata nga e cila vjen me dy anëtarët e tjerë të grupit gjykues të caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për këtë çështje. Sjell në vëmendjen tuaj se në çështjen nr. 5 më herët Këshilli i Lartë Gjyqësor ka caktuar gjyqtarët {...} dhe {...}, ndërsa tashmë është paraqitur nevoja dhe për përcaktimin e një gjyqtari të tretë, ndërsa gjyqtari që ka qenë në përbërje të trupit gjykues është larguar me dorëheqje apo është përjashtuar, dhe kemi

propozuar që gjyqtari i tretë të jetë gjyqtari që është në përbërje të trupit gjykues bashkë me gjyqtarët {...} dhe {...} në gjykatën nga e cila ata vijnë pra Gjykata e Apelit Tiranë. Jeni dakord me këtë?

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Mirë, vazhdojmë procedurat për çështjen civile nr. 6 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Kemi propozuar që të përzgjedhjen me short mes 3 gjyqtarëve të caktuar më herët nga Gjykata e Apelit Tiranë, pra nëpërmjet gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}. Në këtë rast duhet të fusim në një enë çështjen nr. 6 dhe në anën tjetër emrat e 3 gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}.

Do të përzgjidhet emri i një gjyqtari i cili do të caktohet për çështjen civile nr. 6 - {...}.

Vazhdojmë procedurat për 4 çështjet penale nr. 1, 2, 3 dhe 4. Kemi propozuar që për gjykimin e këtyre çështjeve të caktohen gjyqtarët e apelit Durrës që janë caktuar më herët pra gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Ku për çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet 3 gjyqtarë shorti të konsiderohet i ezauruar nga shortet e mëparshme, për çështje nr. 3 do të konsiderohen të caktuar për gjykimin e saj gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Jeni dakord me këtë?

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Viojmë atëherë për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, kemi propozuar që ai të përzgjidhen nga tre gjyqtarët, që janë caktuar për çështjen nr. 3 pra... Atëherë më falni, për çështjen nr. 3 duhet të bëjmë një procedurë shorti për caktimin e relatorit mes gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}, do të fusim në enë emrat e tre gjyqtarëve pra për të përzgjedhur njërin prej tyre, për përzgjedhjen si relator për çështjen nr. 3.

Emir i gjyqtarit është {...}, i cili caktohet si relator për çështjen penale nr. 3.

Nga ana tjetër, për çështjen penale nr. 2, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, janë emrat e dy gjyqtarëve të tjerë që nuk janë përzgjedhur si relatorë për çështjen nr. 3, pra gjyqtarët {...} dhe {...}.

Për çështjet penale nr. 1 dhe nr. 4 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nëpërmjet 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës të caktuar për çështjen nr. 3. Në këtë rast gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e renditur e para në listë, përjashtohet nga përzgjedhja në çështjen e renditur më pas në listë. Do fusim në një enë çështjen nr. 1 dhe nr. 4 dhe në anën tjetër emrat e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, {...}, {...} dhe {...}.

Për çështjen nr. 4 përzgjidhet emri i një gjyqtari - {...}, ndërsa për çështjen nr. 1 përzgjidhet emri i një gjyqtari - {...}.

Atëherë me kaq mbyllen dhe procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**. Mirë atëherë, Gjykata e Apelit Durrës ka paraqitur nevojën në dy çështje civile. Në njërin kërkohet caktim gjyqtari ndërsa në

tjetrën kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët për caktimin e gjykimit të dy çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Apelit Shkodër dhe numri gjyqtarëve që duhet të caktohet të jetë 2. Jeni dakord me këtë propozim?

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Propozimi i Komisionit u pranua. Për ekonomizim të burimeve njerëzore kemi propozuar që në këtë rast të konsiderohet shorti i datës 19.04.2019 përmes të cilit janë përzgjedhur 3 gjyqtarë të gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, mes të cilave duhet të përzgjidhet gjyqtari që duhet të caktohet për çështjen nr. 1 dhe nr. 2 për të cilat kërkohet një ose dy gjyqtarë. Jeni dakord me këtë?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Për çështjen nr. 2 u përzgjedhën gjyqtarët {...} dhe {...} ndërsa për çështjen nr. 1 gjyqtare {...}.

Vazhdojmë me procedurat e **Gjykatës së Apelit Gjirokastrë**. Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka paraqitur nevojën për 3 çështje që janë të treja civile. Në dy çështje kërkohet caktimi i 1 gjyqtari dhe në 1 çështje kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që duhet të caktohen për çështjet gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Korçë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore, të jetë 2. Jeni dakord me këtë propozim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

(Vota e zotit Hallunaj nuk dëgjohet.)

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Meqenëse u pranua propozimi për t'u përzgjedhur gjyqtarët nga Gjykata e Apelit Korçë që të përjashtohet nga çështje nr. 1 nga shorti gjyqtari {...}, që ka pengesë ligjore. Po kështu kemi propozuar që mos të përjashtohet nga procedura e shortit, kryetarja në detyrë {...}, meqenëse Gjykata e Apelit Korçë ka ngarkesë relativisht jo të lartë në raport me gjykatat e tjera dhe është numri i kufizuar i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë që mund të përfshihen në listën e shortit. Jeni dakord me këtë?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Për çështjen nr. 1 për të cilin kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve të cilët do të përzgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë ku duhet të përjashtohet gjyqtari {...}.

Atëherë janë {...}, {...} dhe {...}.

Do të përzgjedhim dy prej tyre të cilët do të caktohen për çështjen nr. 1 - emir i parë është {...} dhe emri i dytë është {...}.

Vijojmë procedurat për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të zgjedhjen me short mes dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë të caktuar për çështjen nr. 1, ku gjyqtari i përzgjedhur i pari është për çështjen e para në listë, pastaj tjetri për çështjen e renditur më pas. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve {...} dhe {...} dhe në enën tjetër numrat e çështjeve 2 dhe 3.

Atëherë përzgjedhim një numër çështjeje - çështja nr. 2. Përzgjedh emrin e një gjyqtari - {...}.

Atëherë çështja nr. 3 është emri i gjyqtarit {...}.

Me kaq procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastër mbyllen.

